




REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. / Dep. / Dep.	Nr. Prot. / B. Prot. / Prot. No.
DPK	03-02/3866/17
Nr. Titull / B. titull / B. titull	Data / Datum / Date
62	22.11.2017
Nr. pagat / P. SHITJE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 21.11.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-2452-17, për Zyrtarin e lartë z.Merxhan Avdyli – Anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit publik “Kadri Zeka” në Gjilan, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me Nr. AKK-03-02-2452/17, për Zyrtarin e lartë, z.Merxhan Anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit publik “Kadri Zeka” në Gjilan, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznes privat, është trajtuar sipas procedurave të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, Agjencia kundër Korrupsionit ka bërë shkresë njoftuese zyrtarit të lartë z.Merxhan Avdyli (DPK-03-02-2983-17), dhe pastaj ai është kontaktuar nga Agjencia kundër Korrupsionit, me ç'rast në takim zyrtar është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Avdyli është deklaruar se brenda afatit të caktuar nga Agjencia, do të bëjë ndryshimet e nevojshme, dhe do të sjell informacionet në Agjenci.

Ndërkohë, z.Avdyli, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë informacionet mbi ndryshimet në biznesin N.SH.“Embata”(DPK/Dpki-03-02/24521/17) të bëra në Agjensionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), në të cilin shihet se, z.Merxhan Avdyli tashmë ka hequr dorë

nga funksioni menaxhues, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Shaip Havolli /

